

Gjykata Supreme e Kosovës
Pkl-Kzz nr. 39/2012
24 prill 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Dr. Horst Proetel si kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarëve të EULEX-it Tore Thomassen dhe Elka Filcheva-Ermenkova, gjyqtarëve të Gjykatës Supreme Salih Toplica dhe Nesrin Lushta si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore Chiara Rojek në cilësi të procesmbajtëses,


Në lëndën penale kundër **Vukmir Cvetkovic** i lindur m ., emri i të atit ., emri dhe mbiemri i vajzërisë i së ëmës ., shtetas i Kosovës, i nacionalitetit serb, adresa e fundit e banimit në rrugën , , ish p ., i ., , , , ,
1 , në paraburgim që prej 10 marsit 2009 (në Kosovë prej 13 korrikut 2010), tani mbahet në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë,

I dënuar në shkallë të parë me aktgjykimin P nr. 285/10 të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 9 nëntor 2010 për vepër penale Krime lufte kundër popullsisë civile në kundërshtim të neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ), në shkelje të nenit 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dhe nenit 1 dhe 17 të protokollit shtesë II të 8 qershorit 1977, të Konventave të Gjenevës së vitit 1949, i dënuar me shtatë (7) vjet burgim, dhe më vonë i konfirmuar në shkallët e dytë me aktgjykimin Ap-Kz nr. 140/11 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 16 gusht 2011,

Duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës Ljubomir Pantovic në emër të të pandehurit Vukmir Cvetkovic kundër të dy aktgjykimeve, të regjistruar në gjykatë më 15 shkurt 2012, dhe sipas përgjigjes së Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSH) ndaj kërkesës së të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 23 mars 2012,

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Ljubomir Pantovic në emër të të pandehurit Vukmir Cvetkovic kundër aktgjykimit P nr. 285/10 të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 9 nëntor 2010 dhe aktgjykimit Ap-Kz nr. 140/11 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 16 gusht 2011 dhe të regjistruar në gjykatë më 15 shkurt 2012 **REFUZOHET** si e pabazuar, dhe si ndryshim në dispozitivin e aktgjykimit Ap-Kz nr. 140/11 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 16 gusht 2011 shtohet referenca në ninjtin 22 të KP RSFJ-së.



ARSYETIMI

I. Historia e procedurës

Më 8 shtator 2010, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzën PPS nr. 18/09 duke akuzuar Vukmir Cvetkovic-in për Krime lufte kundër popullsisë civile në kundërshtim të neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ-së. Më 21 shtator 2010, kjo aktakuzë u konfirmua në tërësi me aktvendimin KAQ nr. 271/10.

Më 26 tetor 2010, filloi shqyrtimi gjyqësor. Në tetor dhe nëntor 2010 janë mbajtur katër seanca, përfshirë një inspektim të vendit të ngjarjes.

Më 09 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë, me aktgjykimin P nr. 285/10 shpalli të pandehurin fajtor për veprat penale Krime lufte kundër popullsisë civile në kundërshtim të neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ-së, në shkelje të nenit 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dhe nenit 1 dhe 17 të protokollit shtesë II të 8 qershorit 1977, të Konventave të Gjenevës së vitit 1949. Sepse “Më 27 ose 28 mars 1999, i pandehuri bashkë me një individ tjeter, të dytë të veshur me uniformë dhe të dytë të armatosur, e detyruan S [REDACTED] T [REDACTED] S [REDACTED] dhe familjen e tij ta lëshojnë shtëpinë e tyre në Klinë dhe të shkojnë në Shqipëri ” dhe “Më 27 ose 28 mars 1999, i pandehuri i veshur me uniformë i vuri zjarrin së paku dy shtëpive në Klinë – shtëpisë së N [REDACTED] S [REDACTED] dhe shtëpisë së Z [REDACTED] dhe K [REDACTED] Q [REDACTED] – duke përdorur flakëhedhësin.” Vukmir Cvetkovic u dënuar me shtatë (7) vjet burgim.

Pas ankesës së mbrojtjes, Gjykata Supreme e Kosovës më 16 gusht 2011 lëshoi aktgjykimin Ap-KZ nr. 140/2011. Kolegji i Gjykatës Supreme pjesërisht pranoi ankesën duke ndryshuar vendimin si në vijim: “Vepra penale e kryer nga i pandehuri cilësohet si krime lufte kundër popullsisë civile në përpjekje me nenin 142 paragrafin 1 të Kodit Penal të Jugosllavisë dhe në shkelje të nenit 3 të katër Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dhe nenit 1 dhe 17 të protokollit të dytë shtesë të 8 qershorit 1977, të Konventave të Gjenevës së vitit 1949.” Pjesët e mbeturë të ankesës u refuzuan si të pabazuara.

Avokati mbrojtës Ljubomir Pantovic paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të Vukmir Cvetkovic e cila është regjistruar në Gjykatën e Qarkut në Pejë më 15 shkurt 2012. ZPSHKA paraqiti përgjigjen ndaj kërkesës së të pandehurit më 23 mars 2012.

II. Parashtresat e palëve

A. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

Mbrojtja paraqiti kërkesë për mbrojte të ligjshmërisë kundër aktgjykimit P nr. 285/10 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, dhe aktgjykimit Ap-KZ nr. 140/2011 të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi baza të shkeljes së ligjit penal, dhe shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale. Ai propozon që Gjykata Supreme e Kosovës ta pranojë kërkesën e tij,

dhe në përputhje me nenin 457 paragafin 1 pikën 2 të KPPK-së, ose t'i ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara me lirimin e të pandehurit, ose t'i anulojë ato dhe ta kthejë lëndën për rigjykim para një kolegji tjeter.

Shkelja e ligjit penal nga nenii 451 paragrafi 1 nën- paragrafi 1 lidhur me nenin 404 paragafin 4 të KPPK-së

Mbrojtja pretendon se dispozitat ligjore në aktgjykimin e kundërshtuar, d.m.th. katër Konventat e Gjenevës së 12 gushtit 1949 dhe nenet 1 dhe 17 të protokollit shtesë II të 8 qershorit 1977 nuk janë zbatuar, duke u bazuar në arsyet në vijim:

- Ligji penal ndërkombëtar në kohën e kryerjes së veprave penale nuk ishte i zbatueshëm drejtpërdrejt në Kosovë.
- Neni 142 i KP RSFJ-së nuk përfshin kushtin e sulmit të shtrirë dhe sistematik kundër çdo popullsie civile, edhe pse i ndërlidhur me ngjarjet që kanë ndodhur në Kosovë.
- Neni 142 nuk i referohet asnjë ligji ndërkombëtar dhe në kohën kritike nuk kishte marrëveshje ekzistuese ndërkombëtare apo europiane për të detyruar zbatimin e menjëherëshëm të këtyre ligjeve.
- Në njëren anë lindin dyshimet përkitazi me zbatueshmërinë e ligjit penal, përkatesisht me pabarazinë në mes zbatimit të menjëherëshëm të ligjit ndërkombëtar dhe garancitë procedurale për të akuzuarin, dhe kushtet eksplikite të Statutit dhe Kodit të RSFJ-së në anën tjetër. Kjo duhet të zgjidhet me zbatimin e parimit *in dubio pro reo*.
- Juridiksi universal nuk ka mundësi të zbatohet.


Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale nga nenii 451 paragrafi 1 nën- paragrafi 2 lidhur me nenin 403 paragafin 1 pikën 12 të KPPK-së

Mbrojtja pohon në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale bazuar në kundërthënie në dispozitivet e aktgjykimeve të kundërshtuara. Referimi ndaj nenit 22 të KP RSFJ-së, ndërsa i pranishëm në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, ishte lënë jashtë aktgjykimit mbi ankesën. Si pasojë e kësaj ndryshon cilësimi juridik i veprave penale, dhe i bën dispozitivet të pakuptueshme.

Mbrojtja po ashtu e kundërshton besueshmërinë e dëshmitarëve dhe gjetjet e gjykatave të shkallës së parë dhe asaj të dyte. Të dyja gjykatat i pranuan dallimet në dëshmitë e dëshmitarëve. Pa marrë parasysh këtë, gjykata e shkallës së parë nuk arriti të bëjë shqyrtimin e plotë të këtyre mospërputhshmërive dhe gjykata e shkallës së dyte vërtetoi gjetjet e Gjykatës së Qarkut në dëm të të akuzuarit. Për arsyet e sipërpërmendura, arsyetimi i aktgjykimeve është i paqartë dhe kundërthënës.

Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale nga nenii 451 paragrafi 1 nën- paragrafi 3 lidhur me nenin 403 paragafin 2 pikën 1 dhe nenin 3 paragafin 2 të KPPK-së

Fillimisht mbrojtja pretendon se përfundimet e gabuara të të dyja gjykatave lidhur me faktet vendimtare është dashur të interpretoheshin nga pikëpamja e nenit 3 paragafit 2 të KPPK-së.



B. Përgjigja e ZPSHK-së

ZPSHK-j ai propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta refuzojë kërkesën e mbrojtjes si të pabazuar në përputhje me nenin 456 të KPPK-së. Prokurori i shtetit përveç kësaj sugjeron të merren parasysh me kujdes vërejtjet shtesë nga përgjigja dhe arrihen përfundimet përkatëse.

Prokurori i shtetit beson se shkeljet e pretenduara të ligjit penal nuk janë meritore. Është e qartë gjatë leximi të aktgjykimit se statuti primar mbi të cilin i pandehuri ishte dënuar ishte ligji përkatës penal i KP RSFJ-së. Fakti se kjo dispozitë është në përputhje me konventat e Gjenevës dhe protokollet e saj shtesë nuk e zvogëlon këtë fakt. Përveç kësaj, referimi në nenin 142 të KP RSFJ-së ndaj ‘rregullave të ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur ose okupimit’ çon deri të përfundimi se ligji i përfshin këto rregulla.

Prokurori i shtetit përmend se RSFJ-ja u bë pjesëmarrëse e Konventave të Gjenevës më 21 prill 1950 dhe pjesëmarrëse e protokolleve shtesë I dhe II të Konventave të Gjenevës më 11 qershor 1979. Legjislacioni u miratua për zbatimin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare. Këto protokolle ishin “drejtpërdrejt të zbatueshme” nga gjykatat e Jugosllavisë në pajtim me nenin 210 të Kushtetutës së ish Jugosllavisë. Kalimi nga RSFJ në FRJ ndodhi më 29 prill 1992. Me anë të shpjegimit të dispozitave të rregullores së UNMIK-ut 2000/59 që ndryshoi Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin në fuqi në Kosovë me nenet 145 paragrafin 2 dhe 19 paragrafin 2 të Kushtetutës së Kosovës, neni 3 i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës dhe nenet 1 dhe 17 të protokollit shtesë II të vitit 1979 kanë të bëjnë me lëndën në fjalë.

Ideja se shkeljet e rënda të ligjit humanitar ndërkombëtar në konfliktet e brendshme të armatosura detyrojnë përgjegjësi individuale penale plotësisht autorizohet nga pikëpamja e së drejtës substanciale dhe paanësisë. Në fund, ekzistimi i sulmit sistematik dhe të shtrirë nuk është kërkesë e veprës penale të Krimtit të luftës.

Sa i përket shkeljeve të pretenduara substanciale të dispozitave të procedurës penale, prokurori i shtetit beson se koleksi i Gjykatës Supreme gabimisht harroi të përmend nenin 22 të KP RSFJ-së në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së dytë. Megjithatë është e qartë se veprimet e kryera nga i pandehuri ishin kryer në bashkëpjesëmarrje ose bashkëkryerje. Prokurori i shtetit fton Gjykatën Supreme t'i zbatojë standarde e njëjtë siç nënvizohen në aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pkl-Kzz nr. 114/09 të datës 12 prill 2010.

Sa i përket pretendimeve për shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, ZPSHK-ja shpreh se këto çështje nuk i takojnë fushës së rishikimit në përputhje me nenin 451 paragrafin 2 të KPPK-së.

Prokurori i shtetit paraqet vërejtjet shtesë.

Prokurori njashtu beson se ndalimi me ligj i veprave të kryera nga Pika 2 gjendet në nenin 13 paragrafin 2 të protokollit shtesë II. Sa i përket Pika 1, Prokurori i shtetit vëren se neni 17 paragrafi 1 protokollit shtesë II, si dhe neni 121 parografi 2 pika 8 e KPK-së, i referohen dhënes së urdhrit për zhvendosjen e popullsisë civile. Përfundimisht, neni 121 i KPK-së duhet të konsiderohet si ligji më i favorshëm për të akuzuarin. Sjellja përtë

cilën i pandehuri është dënuar nuk penalizohet më,¹ dhe ai duhet të dënohet vetëm për një pikë të akuzës.

Sipas këndvështrimit të ZPSHk-së, pasi që mbrojtja nuk e ka debatuar këtë bazë në kërkesë, Gjykata Supreme ndalohet të vendosë përtej kufizimeve strikte të caktuara me nenin 455, paragrafin 1 të KPPK-së. Prokurori i shtetit do të merr parasysh nëse do të ushtrojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në dobi të të pandehurit në fazën e mëvonshme.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme.

Kërkesa refuzohet si e pabazuar.

A. Kompetenca e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente për të vendosur për Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në pajtim me nenet 454 dhe 26, paragrafit 3 të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është përbërë në pajtim me nenin 3, paragrafin 7 të Ligjit nr. 03/L-53 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Kolegi ka mbajtur seancën më 24 prill 2012 në pajtim me nenin 454 të Kodit.

B. Pranueshmëria e Kërkesës për Mbrotjtje të Ligjshmërisë

I pandehuri e pranoi aktgjykimin e fundit të kundërshtuar Ap-Kž nr. 140/2011 më 14 nëntor 2011, ndërsa avokati mbrojtës më 18 nëntor 2011. Kërkesa është regjistruar në Gjykatën e Qarkut më 15 shkurt 2012. Vula postare është e palexueshme për të konstatuar datën e saktë të dërgimit të kërkesës. Dyshimet sa i përket datës aktuale të parashtrimit shkojnë në favor të të akuzuarit. Prandaj, kërkesa konsiderohet si e pranueshme pasi që është parashtruar me kohë nga personi i autorizuar në pajtim me nenet 452, paragrafit 3 dhe 453 të KPPK-së.


C. Meritat e Kërkesës për Mbrotjtje të Ligjshmërisë

Fusha e shqyrtimit të Gjykatës Supreme të Kosovës

Prokurori i Shtetit ka bërë disa vërejtje shtesë që lidhen me fushën e shqyrtimit të ushtruar nga Gjykata Supreme kur e mori kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Kolegji i poshtëshënuar e konstaton të nevojshme të definoj fushën e shqyrtimit të Gjykatës Supreme para se të shkohet me meritat e kërkesës.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është mjet i jashtëzakonshëm juridik që ka përqëllim t'i adresoj shkeljet e dispozitave ligjore që ndikojnë në ligjshmërinë e vendimit

¹ Referencë e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ejup Kabashi, KA nr. 76/11, Aktvendim mbi konfirmim, 29 prill 2011



gjyqësor. Qëllimi i ligjvënësit ka qenë i qartë të kufizoj fushën e shkeljeve të ligjit, e jo të arsyeve të lidhura me gjendjen faktike.² Ky interpretim është konfirmuar nga mungesa e dispozitave lidhur me ekzaminimin sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) të lëndës në këtë fazë të procedurës, e gjithashtu nga jurisprudanca e themeluar prej kohe.³ Ky kufizim është justifikuar me karakter të jashtëzakonshëm të mjetit që ndryshon nga procedura ankimore e cila urdhëron shqyrtim të plotë të fakteve dhe ligjit.

Për më tepër, nen 455, paragrafi 1 i KPPK-së përshkruan që Gjykata Supreme “kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqiteti/ja i/e kërkesës pretendon.” Në mënyrë të qartë vendos kufizimet e shqyrtimit të ushtruar nga Gjykata Supreme. Sado që nen 457, paragrafi 1 siguron për modifikim të mundshëm apo edhe anulim në tërësi apo të pjesshëm të vendimit përfundimtar, që qëndron në atë që Gjykata Supreme duhet të vendos brenda kornizës së definuar në kërkesë.

Prokurori i Shtetit paraqet që i pandehuri nuk duhet të dënohet për pikën 1 të akuzës pasi që kryerja e vetëm zhvendosjes së popullatës civile nuk penalizohet më tutje sipas KPK-së, dhe kjo dispozitë e re duhet të aplikohet si më e favorshmja për të akuzuarin. Kolegji i Gjykatës Supreme shpreh shqetësimet e saj sa i përket këtij pretendimi, që nuk është ngritur në fazën e mëparshme dhe mundet në mënyrë serioze të shkel ligjshmërinë e vendimeve të kontestuar gjyqësore.

Edhe kur i pandehuri nuk do të jetë përgjegjës penalisht pasi që ai mund të mos ketë ‘urdhëruar’ zhvendosjen e popullatës civile në kuptim të ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, kjo nuk do të arsyetonte kërkesën e tanishme. Gjykata Supreme është e lidhur nga dispozitat e këtij Kodi, në veçanti të nenit 455 të KPK-së, që parandalon çfarëdo veprimi të mjetit në këtë bazë. Sa i përket kësaj, Prokurori i shtetit mund të vendos të ushtroj kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të Vukmir Cvetkovic.

Shkelja e ligjit penal sipas nenit 451, Paragrafit 1, nën-paragrafit 1 i lidhur me nenin 404, paragrat 4 të KPPK-së

Gjykata Supreme konsideron që ky pretendim është i pabazuar. Nuk ekziston asnjë dyshim që Gjykata e shkallës së parë e zbaton ligjin duke e penalizuar veprën për të cilën i pandehuri është dënuar.

Faktikisht, nen 142 i KP të RSFJ-së në mënyrë specifike i referohet ‘rregullave të ligjit ndërkombëtar në fuqi gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit’. Këto rregulla në mënyrë të natyrshme përfshijnë nenin 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës dhe të dispozitave të tjera të ligjit humanitar të natyrës fondamentale.

² Shih *inter alia* nen 451, Paragrafi 2 i KPPK-së: Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

³ Lënda e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl-Kzz nr. 13/04, Aktgjykim mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, 9 nëntor 2004: kolegji i Gjykatës Supreme refuzoi kërkesën pasi që nuk ka specifikuar se cilat dispozita të nenit 403 të Kodit janë shkelur dhe nuk ka arritur të kundërshtoj aktgjykim mbi bazat ligjore, se sa në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; shih gjithashtu Gjykata Supreme e Kosovës, Pkl-Kzz nr. 15/04, aktgjykim mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, 9 nëntor 2004

Gjykata Supreme gjithashtu vëren që gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nenin 3 të përbashkët dhe nenet 1 dhe 17 të Protokollit shtesë II. Në fakt formulimi i nenit 142⁴ në mënyrë të qartë tregon se duhet të ushtrohet testi i dualizmit, d.m.th.: sjellja penale duhet të shkelë të dyja, ligjin kombëtar dhe atë ndërkombetar.⁵

Për më tepër siç është dorëzuar nga Prokurori i Shtetit, Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 janë ratifikuar nga Republika Popullore e Jugosllavisë më 21 prill 1950 dhe ka hyrë në fuqi më 21 tetor 1950. Protokollet shtesë I dhe II kanë hyrë në fuqi në Jugosllavi më 26 dhjetor 1978. The RFJ u bë palë e Protokolleve shtesë I dhe II të Konventave të Gjenevës më 11 qershor 1979. Konventat dhe protokolli shtesë II ishin të zbatueshme në Kosovë gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur duke ndodhur në territorin e njërs nga Palët e larta kontraktuese. Ratifikimi i tyre në palët kontraktuese është i mjaftueshëm të krijoj obligime të palëve të kundërtë në konflikt që ti binden këtyre dispozitave. Përfundimisht, neni 3 i përbashkët në të vërtetë është pjesë e ligjit zakonor dhe pragu minimal i mbrojtjes i kufizuar në dispozitat e saj duhet të respektohet nga palët kontraktuese në çfarëdo kohe në rast të konfliktit të brendshëm të armatosur.⁶

Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 451 paragrafit 1 nën-paragrafit 2 i lidhur me nenin 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së

Kjo parashtresë e mbrojtjes gjithashtu është refuzuar. Gjykata Supreme e pranon që nuk ekziston referencë në nenin 22 të KP të RSFJ-së në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë.⁷ Megjithatë, kolegji nuk pajtohet me mbrojtjen që dispozitivi është i paqartë sa i përket cilësimit ligjor të sjelljes penale. Gjykata Supreme konfirmoi aktgjykimin e

⁴ Neni 142 i KP të RSFJ-së: “Kushdo duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombe tar gjatë kohës së luftës, të konfliktit të armatosur ose të okupacionit, [...]”.

⁵ Shih *inter alia* UNMIK DC Prizren, C nr. 226/01, Aktgjykimi i shkallës së parë 31 janar 2003, faqe 12: “neni 142(1) gjithashtu kërkon që krimet e luftës të jenë në shkelje të “rregulloreve të së drejtës ndërkombe tar gjatë kohës së luftës, të konfliktit të armatosur ose okupacionit” Prandaj në përputhje me rrethanat, kjo deklaratë kufizon aplikimin e Nenit 142 deri në atë nivel që cilado prej akteve të paraqitura janë gjithashtu në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombe tar. [...]”;UNMIK GjQ Prishtinë, C nr. 425/01, 16 korrik 2003, faqet 16 dhe në vijim.

⁶ Lënda IT-94-1-AR72, Prokurori kundër Dusko Tadic, Vendimi për Mocionin e Mbrotjjes për Apelimin e Ndërkokshëm në lidhje me Juridiksonin, 2 tetor 1995, para. 98: “Urgjenca e rregullave ndërkombe tar lidhur me konfliktin e brendshëm ka ndodhur në dy nivele të ndryshme: në nivelin e ligjit zakonor dhe të ligjit të traktatit. Kështu janë kristalizuar dy autoritete të rregullave, të cilat nuk janë në kundërshtim ose në mospërputhje, por përkundrazi përkrahin dhe plotësojnë njëra tjetrën. Në të vërtetë, bashkëveprimi në mes të këtyre dy rregullave është i atillë që disa rregulla të traktatit në mënyrë graduale janë bërë pjesë e ligjit zakonor. Kjo përmban të vërtetën për nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, [...]; shih gjithashtu lëndën IT-96-23 dhe IT-96-23/1, Prokurori kundër Dragoljub Kunarac et al., Aktgjykimi i shkallës së dytë, 12 qershor 2002, para 68

⁷ Shih Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kž nr. 140/11, 16 gusht 2011, dispozitivi, faqe 3: “Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës Ljubomir Pantović në emër të të pandehurit me anë të kësaj aprovohet pjesërisht dhe aktgjykimi i ankimuar ndryshohet si në vijim: Vepra penale e kryer nga i pandehur i është cilësuar si Krim Luftë kundër Popullatës Civile në pajtim me nenin 142 paragrafin 1 të Kodit Penal të Jugosllavisë dhe në shkelje të nenit 3 të Konventës së Katërt të Gjenevës së 12 gushtit 1949 dhe neneve të 17 të Protokollit të dytë Plotësues të 8 qershorit 1977 në Konventat e Gjenevës të vitit 1949. Si pjesë të mbetur, ankesa është refuzuar si e pabazuar dhe është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë.”

shkallës së parë, duke përfshirë që vepra është kryer duke e shkelur nenet 22 dhe 142 të KP të RSFJ-së. Duket se referenca në nenin 22 thjeshtë lënë anash apo rezulton nga gabimi tipografik që mundet lehtë të përmirësohet. Përfundimisht, duke shqyrtuar aktgjykimin e atakuar është e dukshme që gjykata e shkallës së dytë nënkupton të përmend që sjellja penale e Krimave të Luftës kundër popullatës civile është kryer në bashkëpunim siç përcaktohet në nenin 22. Duke i marr parasysh parimet e efikasitetit dhe arsyeshmërisë së procedurës penale dhe të jurisprudencës të referuar nga Prokurori i Shtetit,⁸ kolegji i caktuar konstaton të panevojshme të dërgoj lëndën prapa për ri-gjykim vetëm për shkak të pamjaftueshmërisë në dispozitiv.

Gjykata Supreme gjithashtu e merr parasysh pretendimin e dytë e lidhur me mospërputhjet në deklaratat e dëshmitarit në aktgjykimet e kundërshtuara pa meritë. Është vërejtur që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të kujdeshme ka shqyrtuar deklaratat e dëshmitarit dhe dallimet në mes të dëshmive të dhëna në gjykatë dhe deklaratave të mëparshme të dëshmitarit. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në mënyrë të gjatë ofron shpjegimet e detajuara mbi këto mospërputhje.⁹ Pranimi që “një numër i mospërputhjeve në mes të deklaratave të të njëjtë dëshmitarë të dhëna në raste të ndryshme mund të vërtetohet” Gjykata e shkallës së dytë e arriti përfundimin që “aktgjykimi i atakuar nuk përmban arsyetim mospajtues bazuar në vlerësimin e dobët apo të gabuar të provave”.¹⁰ Ky kolegji i Gjykatës Supreme konstaton që vlerësimi i deklaratave është bërë në mënyrë të duhur nga gjykata e shkallës së parë. Kolegji i caktuar ka vërtetuar këto konstatime dhe që asnjë shkelje e nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së nuk mund të gjendet në të dy aktgjykimet.

Gjykata Supreme nuk ka vërtetuar shkelje që do të ndikonte në ligjshmërinë e vendimeve. Rregulla *in dubio pro reo* zbatohet vetëm kur gjykata duke vlerësuar deklaratat nuk është e bindur në ekzistimin e fakteve, që nuk është rast në këtë shkallë. Baza lidhur me shkeljen substanciale të dispozitave të procedurës penale e lidhur me nenin 403 paragrin 2 pikën 1 dhe nenin 3 paragrin 2 të KPPK-së refuzohet si e pabazuar.

Prandaj, është vendosur si në dispozitiv.

Kryetar i kolegjit

Horst Proetel
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar e kolegjit

Nesrin Lushta
Gjyqtare vendore

⁸ Lënda e Gjykatës Supreme, Pkl-Kzz nr. 114/09, Aktgjykimi në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, 12 prill 2010

⁹ Shih Gjykata e Qarkut në Pejë, P nr. 285/10, Aktgjykimi i shkallës së parë, 9. nëntor 2010, pjesa E, faqet 7-12

¹⁰ Shih Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kž nr. 140/11, Aktgjykimi i shkallës së dytë, 16 gusht 2011, pjesa II., faqet 7-9

Anëtar i kolegjit

Salih Toplica, Gjyqtar vendor

Anëtare e kolegjit

Elka Filcheva-Ermenkova
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtar i kolegjit

Tore Thomassen, Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtëse

Chiara Rojek, Zyrtare Ligjore

Gjykata Supreme e Kosovës

Pkl-Kzz nr. 39/2012

Prishtinë

24 prill 2012

